



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Punëdhënësi/Proletori Received/Delivered	12.08.2022	viti god year	2022
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
STRUKCIMA	4694/2022		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.588/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.588/2022 të datës 01.07.2022, të parashtruar nga grup ankuesish-dhe .undër Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.588/2022 të datës 01.07.2022 të parashtruar nga - dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe më datë 01.07.2022 kanë parashtruar ankesën me numër protokollit 3847/2022 të datës 01.07.2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, për shkak të mos pagesës së punës jashtë orarit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 06.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë, ndërsa kjo e fundit me datë 13.07.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3847/2022 të datës 01.07.2022 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër të protokollit 07/4-1994



të datës 16.05.2022 për pagesë për punë jashtë orarit-për programin e pagesave direkte 2021; Emalin e datës 13.05.2022 të drejtuar Kërkesën me numër reference AZHB 107104/01//351/21 për aprovim; Tabelën përmbledhëse të orëve dhe kompensimit tetor-nëntor -dhjetor 2021; Vendimin me numër Ref.AZHB07/4/54/2021 të datës 23.04.2021 për transfer të përkohshëm të zyrtarëve; Vendimin me numër Ref.AZHB-07/4/181/2021 të datës 10.12.2021 për punë jashtë orarit; Vendimin me numër Ref.AZHB;07/4/153/2021 të datës 08.10.2021 për transferim të përkohshëm të zyrtarëve; Kërkesën me numër të protokollit 07/4-2552 të datës 17.06.2022 për përsëritje të pagesës jashtë orarit; Vendimin me numër Ref.AZHB07/454/2021 të datës 23.04.2021 për transferim të përkohshëm të zyrtarëve; Vendimin me numër Ref.AZHB:07/4/153/2021 të datës 08.10.2021 për transferim të përkohshëm të zyrtarëve; Vendimin me numër Ref.ZSP.1010/21 nr.769 të datës 29.10.2021 për angazhim shtesë të stafit të zyrtarëve publik gjatë vikendit me dt. 30.10.2021; Vendimin me numër të protokollit Ref.ZSP-1020/21 Nr.775 të datës 04.11.2021 për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të punës dhe gjatë fundjavës; Vendimin me numër Ref.ZSP.1081/2021 Nr.820 të datës 19.11.2021 për angazhim shtesë të zyrtarëve publik gjatë vikendit me datën 20.11.2021; Vendimin me numër Ref.AZHB-07/4/181/2021 të datës 10.12.2021 për punë jashtë orarit; Emalin zyrtar të datës 18.12.2021 nga drejtuar Emalin zyrtar të datës 03.12.2021 të drejtuar Emalin zyrtar të datës 27.10.2021 të drejtuar Emailin zyrtar të datës 24.12.2021 të drejtuar dhe Kantatën e punës me numër të protokollit 941 të datës 09.03.2021 të nëpunësit Pasqyra e llogarisë Trusti për periudhën kohore 17.08.2017 deri me 21.06.2022; Kontratën e punës me numër të protokollit 939 të datës 09.03.2021 të nëpunësit Pasqyrën e llogarisë Trustin për periudhën kohore 21.07.2017 deri më 21.06.2022; Kontratën e punës me numër të protokollit 1004 të datës 11.08.2021 të nëpunësit Pasqyra e llogarisë Trusti për periudhën kohore 10.01.2017 deri me datën 21.06.2022; Kontratën e punës me numër të protokollit 942 të datës 09.03.2021 të nëpunësit Pasqyra e llogarisë Trusti për periudhën kohore 04.08.2021 deri me datën 21.06.2022; Kontratën e punës me numër të protokollit 940 të datës 09.03.2021 të nëpunësit Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3959/2022 të datës 06.07.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 4069/2022 të datës 13.07.2022; Kërkesën për aprovim me numër të protokollit 7434 të datës 29.12.2021; Emalin zyrtar të datës 24.12.2021 të drejtuar Emalin zyrtar të datës 03.12.2021 të drejtuar Emalin zyrtar të datës 12.11.2021 të drejtuar I.Limani; Emalin zyrtar të datës 05.11.2021 të drejtuar Emalin zyrtar të datës 29.10.2021 të drejtuar Emalin zyrtar të datës 27.10.2021 të drejtuar Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 04.12.2021; Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 11.12.2021; Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 18.12.2021; Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 25.12.2021; Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 27.12.2021; Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 30.10.2021; Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 06.11.2021; Emalin zyrtar të datës 30.11.2021 të drejtuar Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 13.11.2021; Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 20.11.2021; Lista e hyrje daljes së zyrtarëve në MZHR-së të datës 27.11.2022.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar provat materiale lidhur me këtë çështje juridike, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga -

dhe **SEPSE:**





Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesit kanë krijuar marrëdhënia të punës me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural sipas kontratës publike për shërbime të veçanta dhe atë: ankuesi sipas Kontratës me numër të protokollit 941 të datës 09.03.2021 "Shërbime konsulentë nëpërmjet Marrëveshjes për shërbimeve të veçanta( konsulent individ) për nevoja të AZHB-së" në pozitën "Zyrtar i autorizimit të pagesave për nevojat e AZHB-së", me kohëzgjatje nga data 09.03.2021 deri me datën 08.03.2024, ankuesja sipas kontratës me numër protokollit 939 të datës 09.03.2021, Marrëveshjes për shërbimeve të veçanta(konsulent individ) për nevoja të AZHB-së në pozitën "Zyrtare e autorizimit të pagesave për nevojat e AZHB-së", me kohëzgjatje nga data 09.03.2021 deri me datën 08.03.2024, ankuesja sipas kontratës me numër protokollit 1004 të datës 01.03.2021, "Shërbime konsulentë nëpërmjet Marrëveshjes për shërbimeve të veçanta( konsulent individ) për nevoja të AZHB-së" në pozitën "Zyrtare e Miratimit të Projekteve për nevojat e AZHB-së", me kohëzgjatje nga data 11.03.2021 deri me datën 10.03.2024, ankuesja sipas kontratës me numër të protokollit 942 të datës 09.03.2021, "Shërbime konsulentë nëpërmjet Marrëveshjes për shërbimeve të veçanta( konsulent individ) për nevoja të AZHB-së" në pozitën "Zyrtar e Arkivës për nevojat e AZHB-së", me kohëzgjatje nga data 09.03.2021 deri me datën 08.03.2024, ankuesi sipas kontratës me numër protokollit 940 të datës 09.03.2021, "Shërbime konsulentë nëpërmjet Marrëveshjes për shërbimeve të veçanta( konsulent individ) për nevoja të AZHB-së" në pozitën "Zyrtar i Miratimit të Projekteve për nevojat e AZHB-së", me kohëzgjatje nga data 09.03.2021 deri me datën 08.03.2024.

Në ankesën e pashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ankuesit pretendojnë së me Vendimin me numër protokollit 07/04-7000 të datës 10.12.2021 të Zv. Kryeshefes Ekzekutive të AZHB-së, ankuesit janë caktuar që të punojnë jashtë orarit të punës por që të njëjtit nuk janë kompensuar sipas këtij vendimi.

Lidhur me pranueshmerinë e ankesës, Kolegji i Këshillit ju referuar nenit 32 të Ligjit Nr.06/114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: 1. Marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil (në vijim: marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil) është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative. 2. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me aktin e emërimit dhe, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj, është e përhershme (me afat të pacaktuar). 3. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji..., si dhe nenit 2 paragrafi 3 po të këtij ligji ku theksohet se: nëpunës civil është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton së marrëdhënia e punës në shërbimin civil është marrëdhënia e natyrës juridike administrative e cila krijohet, ndryshohet dhe përfundon vetëm sipas dispozitave të legjislacionit për shërbimin civil, andaj, mbi këtë bazë ligjore dhe duke marrë parasysh së ankuesit kanë themeluar marrëdhënia pune me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sipas kontratave konsulente për shërbime të veçanta përkatësisht sipas legjislacionit të prokurimit publik, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ku



përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në Shërbim Civil, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.588/2022 të datës 01.07.2022.

Në kuptim të udhëzimit të palas ankuese, ashtu siç është përcaktuar në pjesën III të kontratave konsulente, çdo mos marrëveshje e lindur ndërmjet palëve në marrëveshje zgjidhet në gjykatë të rregullt themelore.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.588/2022

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj-DËMI**

*Kryetare e Kolegjit*



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesve;
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

